



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr. 10, datë 11.7. 2016

PËR

MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”,
PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC “SKATINË”,
ME VENDNDODHJE: PELLGU UJËMBLEDHËS I PËRROIT
SKATINË, NJËSIA ADMINISTRATIVE BYTYÇ, BASHKIA TROPOJË,
QARKU KUKËS

Në mbështetje të shkronjës “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor”, për prodhim hidroenergjie, shoqërisë “Skatinë-HEC” sh.p.k., për HEC-in “Skatinë”, me vendndodhje: pellgu ujëmbledhës i përroit Skatinë, njësia administrative Bytyç, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR

NIKO PELESHI

